



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT**

**VENDIM**

Nr. 13, datë 12.02.2020

**MBI**

**“MIRATIMIN PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË  
TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR “PERKUSION”, TË  
PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI I INTERPRETIMIT, NË UNIVERSITETIN E  
ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019); Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 20, datë 10.02.2020 “Mbi miratimin për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor ‘Perkusion’, të paraqitur nga Departamenti i Interpretimit pranë Fakultetit të Muzikës”; si dhe në shkresën e Kryetarit të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve, Prof. Kastriot Çausi, me lëndë “Kërkesë për miratim”, drejtuar Bordit të Administrimit së UART dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi dokumentacionin e paraqitur, me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor ‘Perkusion’, të paraqitur nga Departamenti i Interpretimit pranë Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim të dërgohet për miratim përfundimtar pranë MASR.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Muzikës të Universitetit të Arteve.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.





Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Besnik Bisha (Kryetar)**

**Prof. Arben Basha (Anëtar)**

**Prof. Artan Peqini (Anëtar)**

**Lorenc Vangjeli (Anëtar)**

**Risena Xhaja (Anëtar)**

**Aida Martiro (Anëtar)**

**Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)**

